



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.11.2015 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e komunës z. Idriz Vehapin, Nënkryetarin e komunës z. Xhemajli Haxhimustafa, delegatët e pranishëm në këtë seancë, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, KFORIN, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Besoj se rendin e ditës si dhe materialin e keni marrë me kohë, a ka ndonjë prej delegatëve ndonjë vërejtje sa i përket pranimit të materialit. Po ashtu a ka ndonjë delegat që ta arsyetojë mungesën në mbledhjen e kaluar?

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit financiar për realizimin e Buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2015,
3. Shqyrtimi i Raportit për përfundimin e vitit shkollor 2014/2015 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2015/2016,
4. Marrja e Vendimit për vënie në debat publik të Rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Rahovecit,
5. Shqyrtimi i Projekt Rregullores për plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba 01 Nr.238 të datës 30.01.2015,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi Draft Planit Lokal të Veprimt për ri integrim,
7. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi - Për këtë mbledhje të rendit të ditës do i diskutojmë këto pika të rendit të ditës ndërsa pikët e tjera në mbledhjen tjetër të cilën do e mbajmë në muajin dhjetor, arsyeja është se kemi shumë pika të rendit të ditës për sot.

Fatmir Iska – Mungon edhe një pikë në KPF jemi mare vesh që të jetë si pikë e rendit të ditës edhe çështja e stacionit të rendit të ditës.

Kryesuesi – Për këtë pikë ne nuk kemi mare kurrfarë materiali prandaj nuk e kemi përfshi në rend të ditës. E qesë në aprovim rendin e ditës me këto 7 pika: Konstatohet se rendi i ditës është aprovuar në mënyrë unanime. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Në postën elektronike nuk ka pas ndonjë vërejtje, ka dikush ndonjë vërejtje ta bëj tani. E qesë në aprovim procesverbalin: konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës, kalojmë pikën e dytë të rendit të ditës,

2. Shqyrtimi i Raportit financiar për realizimin e Buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2015,

Lulzim Sylejmani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Para jush keni raportin 9 muajor janar – shtator 2015 njëkohësisht ky raporte është i krahasuar me vitin 2014 për të njëjtën periudhë. Qëllimi i këtij raporti është që të njoftohen të gjithë kuvendarët dhe të gjithë të pranishmit të tjerë në lidhje me buxhetin e komunës së Rahovecit. Raporti është i plotësua në detaje dhe secili raporte është më i detajuar se raporti tjetër duke ju falënderuar vërejtjet dhe sugjerimet e juaja që i bëni si kuvendar. Sa i përket të hyrat të realizuara për të njëjtën periudhë në vitin 2015 realizimi i të hyrave është 576,538.00 € të hyrat bazë, në krahasim me vitin 2014 ku kanë qenë 606,654.10 €, pra një diferencë më pak prej 30,115.15 €. Në faqe 5 janë total të hyrat prej gjitha kategorive, ku edhe këtu kemi një diferencë prej 9 muajorshit të vitit të kaluar në total prej 40,798.95 € më pak. Në gjomat e gjykatave kemi një diferencë pluse 8.000 € ndërsa tek gjomat e trafikut kemi një minus prej 26,670.00 €. Po ashtu e keni edhe raportin 2014/2015 në bazë të realizimit muajor tek të hyrat vetanake. Në faqe 10 janë prezantuar ndaras të hyrat e tatimit në pronë ku në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar

kemi më pak 31,802.33 €, tek tatimi në pronë në gjitha komunat ka qenë falja e borxheve që është bërë nga Qeveria qendrore, besojmë se këto dy muaj do mbërrijmë realizimin e vitit 2014. Tek regjistrimi i tatim në pronë i objekteve të reja në 2014 kemi pas 327 objekte, ndërsa në vitin 2015 për të njëjtën periudhë kemi pas 510 objekte. Në faqe 10 tek realizimi e kemi ndarë nga fatura e tatimit në pronë që është 342,992.00 € për vitin 2015, janë inkasuar 200,067.56 €. Nga ngarkesa e kamatave të vitit paraprak të akumuluar që janë 54,202.00 € janë paguar

vetëm 7,859.56 €. Nga ngarkesat e pagesave paraprake ose dënimet të akumuluar në vlerën 17,822.33 € janë paguar 4,440.93 €, gjithsej realizimi nga tatimi në periudhën 9 mujore ka qenë 212,365.05 €. Një risi në këtë raporte është që nuk ka pas në raportet e tjera është edhe tatimi në pronë sipas lokaliteteve. Në faqe 14 fillon shpenzimi i buxhetit të vitit 2015 nga grandit qeveritar, ndërsa në faqen 15 e keni nga të hyrat vetanake, po ashtu në faqe 15 është edhe grandit i donatorëve. Në faqe 16 e keni të pasqyruar shpenzimin total të buxhetit ku nga 11,438,701.01 € janë shpenzuar në gjitha kategoritë 8,246,527.83 € ose 72.09 % e buxhetit total. Nga faqja 17 janë të pasqyruara shpenzimet e mallrave dhe tabela e totalit në faqe 24-25 pasqyron të gjitha shpenzimet në kategori të ndryshme nëpër drejtori ndaras, ku në këto shpenzime përveç shpenzimeve reale që janë bërë në 2015 ka edhe kontrata që kemi bërë me përmbarues privatë për shpenzimet e vjetra. Në funde e kemi pasqyruar edhe gjendjen e faturave për pagesë që janë në pritje, faturat në pritje në vitin 2013 kanë qenë 2.2 milion, ndërsa faturat në pritje me 31.12.2014 kanë qenë 830.000 €, ndërsa fituarat në pritje të pasqyruara në këtë raporte për 9 mujorin e këtij viti të cilat i kemi dërguar në thesar janë afër 340.000 €. Jemi munduar që të gjitha informacionet që ju i keni kërkuar ti pasqyrojmë në këtë raporte, raporti vjetor nuk do të thotë që nuk do të jetë i plotësuar me kërkesat e tjera dhe të jetë edhe ma i kompletuar se sa ky raporte sepse do të pasqyron raportin vjetor për vitin 2015.

Selim Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, ky raporte është raporte më i detajuar në krahasim me raportet e tjera. Jemi duke parë se të hyrat vetanake në këtë vite janë më të vogla në krahasim me dy vitet e fundit. Dua të ndalem ma shumë tek krahasimi i të hyrave të realizuara janar – shkurtë, në faqe 7 pika 50 48 qiraja nga objektet publike dua një sqarim nga drejtori dhe po ashtu tek inspektimi dhe respektimi i planit urbanistik në vitin e kaluar janë 22.000 € kurse në vitin 2015 vetëm 790.00 €. Në faqe 14 tek raporti i shpenzimeve sipas drejtorive, kuvendi komunal shpenzime ka bërë 10,201.00 € dua ta di se ku janë bërë këto shpenzime nga ana e kuvendit. Në faqe 16 tek raporti i shpenzimeve ekonomike, në kolonën e dytë ku është buxheti i planifikuar për 2016 dhe të hyrat vetanake për 2015, kjo shumë që është këtu nuk e di a është buxhet i planifikuar për vitin 2016 apo janë të hyrat vetanake. Në faqe 26 pika 14 41 0 shpenzimet e gjykatave 20,571.00 € edhe këtu dua një sqarim.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjitha të pranishmit, do të diskutoj rreth të hyrave vetanake që i ka komuna jonë, planifikimi për vitin 2015 është bërë diku rreth 1,55,000.00 € ndërsa realizimi është bërë diku 567.000 €, kam një pyetje se çfarë planifikimi ka qeverisja aktuale për ti realizuar synimin e tyre kur e dimë se vetëm një kategori e të hyrave vetanake nga pyjet kemi 116.00 € për 1 vit, dua ta di se a është puna e mos interesimi i zyrtarëve që janë duke i ruajtur pyjet sepse është shumë një vlerë e vogël.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për drejtorin, drejtori tha edhe me gjithë faljen e borxheve kemi me arrit realizimin e synuar të të hyrave vetanake, pyetja ime është a ka planifikuar drejtori për 2015 faljen e borxheve.

Fatmir Iska – Falënderoj drejtorin për këtë raporte të detajuar, në faqe 4 do t flasë gjithmonë për përdhën krahasuese janar - shtator 2014 dhe 2015. Të realizuar në 2014 kemi 606.000 € ndërsa në 2015 kemi 576.000 €, pra kemi më pak rreth 30.000 €, ndërsa në raporte me planin deri më tani është realizuar 52.46 %. Faqe 6 ku kemi krahasimin e të hyrave tek gjobot e trafikut dhe gjobot e gjykatave, gjobot e trafikut kemi 45.000 € për 2015 ndërsa në krahasim me 2014 kemi 26,670.00 € më pak, mendoj se në funde të vitit këto të hyra nga gjobot do të shtohen sepse jo vetëm në komunën ton por në gjithë Kosovën në fund të vitit ritën gjobot e trafikut, këto janë politikat e qeverive. Tek gjobot e gjykatave janë të pasqyruara shifrat deri në muajin korrik dhe kemi një rritje prej 8,351.00 €, por dua ta di se a kemi ne si komunë raste të fituar sa i përket kontesteve ndërmjet procedurës gjyqësore dhe asaj administrative. Dhe duke i bashkuar këto dy kategori buxheti i tyre është 687,090.00 € nëse e kthejmë në përqindje në raporte me planin e realizimit të të hyrave për vitin 2015 do të del

62.51 % mendij se nëse shkojmë me këtë ritëm nuk mundemi të realizojmë as 80 % të planit të të hyrave. Faqe 7 tek kodi 50 009 taksa komunale për leje ndërtimi në 2014 kemi 2.000 € ndërsa në 2015 kemi 10.000 €. Taksa me kodin 50 503 inspektimi i respektimit të planit urbanistik në 2014 kemi 22.000 € ndërsa në 2015 vetëm 790.00 € dua një përgjigje për këtë pse kaq pak në vitin 2015. Në faqen 17 tek raporti për mallra dhe shërbime sipas drejtorive, por neve na intereson është për asamblenë komunale ku kemi mëditjet e udhëtimit 1,321.00 € mirë është që të na tregoj kryesuesi se ku janë shpenzuar këto mjete, shërbime të kontraktuara tjera 6,120.00 € gjithnjë për vitin 2015, dua të di se cilat janë këto shërbime që janë kryer nga ana e kuvendit. Në faqe 21 në Drejtorin e Arsimit tek udhëtime për nxënës kemi një rritje shumë të madhe, dua një përgjigje nga drejtoresha se pse është bërë kjo rritje, në 2014 kemi vetëm 4,685.00 € ndërsa në 2015 kemi 9,212.00 €. Tek raporti i krahasimit 9 mujor për mallra dhe shërbime sipas kodeve në faqe 24,25,26, tek mëditjet e udhëtimit kemi një rritje në 2014 kemi 3,877.00 € ndërsa në 2015 kemi 6,803.00 € kemi plotë 3.000 € më shumë mëditje të udhëtimit tek ekzekutivi

komunal. Tek kodi 13 460 shërbimet e kontraktuara tjera në krahasim me vitin 2014 kemi plotë 21.000 më shumë, dua ta di se pse kemi gjitha këto shërbime të kontraktuara ose kontrata mbi vepër nëse marrim parasysh realizimin e të hyrave të cilat janë m pak. Po ashtu tek kodi 13 509 në 2015 kemi rritje në furnizim ushqim dhe pije prej 6.000 €. Gjithashtu në faqe 25 kodi 13 720 naftë për ngrohje në 2015 kemi më pak shpenzim që është për tu lavdëruar, por besoj se në sezonin dimëror do të ketë ngritje. Karburant për vetura kemi një zvogëlim prej 18.000 € edhe kjo është për tu lavdëruar sepse është shumë mirë për komunën ton. Tek kodi 14 050 faqe 25 ku shkruan mir.or.dhe paim nuk e di se çka është mirë është që drejtori të na shpjegoj se nuk kuptoj se çka do të thotë, këtu kemi 10.000 € shpenzime. Në total kemi rritje të shpenzimeve prej 50,467.00 €, pra kemi rritje të shpenzimeve dhe shumë rrënje të hyrave vetanake.

Florije Boshnjaku – Ne në KPF kemi diskutuar dhe kemi marrë konkluzion që drejtori në fillim të del para kuvendit dhe ti njoftoj kuvendarët se cilat kanë qen propozimet dhe ndryshimet tona. Drejtori i financave i ka bërë disa përmasime i ka futur në raporte financiar propozimet tona. Dua vetëm një sqarim tek drejtoria e inspektoratit, ku thuhet se tek mallrat dhe shërbimet i kanë shpenzuar 9.000 €, tek kuvendi thuhet se janë harxhuar 10.000 € mallra dhe shërbime, po ashtu edhe zyra për komunitete 12.000 €. Dua një sqarim për këto kategori se ku janë harxhuar këto mjete.

Beatrisa Demiri – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, është e vërtetë se janë dhënë disa rekomandime në KPF dhe që jemi dakorduar që të njëjtët gjëra të mos përsëriten edhe në Kuvend. Sa i përket raportit është raporti ma i detajuar që na ka ardhur deri më tani në kuvend. E përgëzoj ekzekutivin që i kanë zvogëluar shpenzimet e lüksit për këto dy vite.

Azbi Gashi – Përsëritet për të gjithë, faqe 16 ku thuhet buxheti i planifikimit për vitin 2016 dhe të hyrat vetanake 2015, dua një sqarim për këtë. Po ashtu tek shpenzimet komunale kolona e 3 është shuma 0.01 € mos është ndonjë gabim teknik. Faqe 17 tek asambleja mëditjet e udhëtimit 1,321.40 €. Tek ushqim dhe pije jam duke parë se ka një rrënjë në vitin 2015. Tek regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve tek zyra e Kryetarit, regjistrim të automjetit 186.00 € ndërsa sigurim të automjetit 162.00 €. Tek asambleje komunale 1,026.00 € mirëmbajtje të automjetit. Tek zyra e komuniteteve shërbimet e kontraktuara tjera është 5,490.00 €. Regjistrim të automjeteve 480.00 € dhe sigurim të automjeteve 162.00 € kemi tek zyra për komunitete, dua një përgjigje pse ka diferencë kaq të madhe në mes regjistrimit dhe sigurimit të automjeteve. Ka edhe në disa drejtori kesi lloj diferencash tek regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve.

Kadri Dellova – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, sot para vetës e kemi një raporte shumë të kompletuar dhe të përgatitur shumë mirë, këtë raporte drejtorët e tjerë duhet ta marrin si model për të përgatitur edhe ata kesi lloj raporti. Qeveria aktuale në krye me Kryetarin Idriz Vehapi taksat komunale të qytetarëve të komunës së Rahovecit është duke i shpenzuar aty ku është vendi dhe të gjithë jemi duke parë se sa ka ra niveli i shpenzimeve në këtë qeverisje. Faqe 8 tek raporti i shpenzimeve, në 2014 për shërbime postare kanë qenë 2,261.85 € ndërsa në 2015 është 5,213.00 €, më duket si një diferencë e madhe mos është bërë pagesa e borxhit të vjetër nëse mundet drejtori të më jep një përgjigje.

Afrim Limani – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, pajtohem edhe unë që ky raporte financiar është i detajuar, por prapë ky raporte nuk është i kompletuar sepse i mungon pjesa më e rëndësishme pjesa e zyrës së Prokurimit, ne si këshilltar duhet ta dimë gjendjen e zyrës së prokurimit për 9 mujorin e vitit 2015. Po ashtu i mungon edhe një pjesë shumë e rëndësishme realizimi dhe shpenzimi i buxhetit tek komunalit. Gjithashtu raporti ka shumë gabime teknike dhe e kisha lutë drejtorin që ti korrigjoj. Tek të hyrat kemi një rrënjë të të hyrave që kryesisht vijnë nga tatimi në pronë, por pajtohem me drejtorin e financave që thotë ka ndikuar vendimi mbi shlyerjen e borxhit që është marrë nga Qeveria qendrore. Nuk është gjithmonë performancë e komunës çdo lloj e të hyrave. Vetëm shikoni raportin nga viti 2010 e deri më tani sa kemi të hyra në komunën tonë dhe kjo tregon se në çfarë gjendje është ekonomia e komunës së Rahovecit. Në faqe 10 ka një mbi vlerësim diku 5.00 € në raporte me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pra ka mospërputhje të vlerave. Realizimi i buxhetit në raporte me kohën mendoj se qëndron mirë diku në total kemi 72 % të realizimit të buxhetit. Tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pjesa analitike e realizimit të buxhetit mua më intereson tek shërbimet kontraktuese tjera tek asambleja ku kemi një shpenzim prej 6,120.00 € më intereson ta di se ku janë shpenzuar këto pare. Tek zyra e kryetarit kemi një shpenzim prej 4,878.00 € për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, jam i sigurt se Kryetari nuk i ka shpenzuar këto mjete prandaj e sugjeroj drejtorin që të ketë kujdes që mjetet nga zyra e kryetarit që mos ti lëviz shumë. Shpenzimet në përgjithësi janë më të vogla dhe më të arsyeshme në raporte me vitin e kaluar. Tek kodi 13 460 kemi një shpenzim të madh në shumë prej 60,316.00 € dhe për mendimin tim ky shpenzim është i pa arsyeshëm.

Lulzim Sylejmani – Faleminderit për pyetjet dhe sugjerimet e juaja sepse do i kontribuoni punës sonë që të jemi ma preciz dhe më të saktë në punë. Po ja nisi me përgjigje nga Afrim Limani, tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve sidomos tek zyra e Kryetarit, ato shpenzime që i kemi cek janë të sakta dhe aty janë shpenzuar sepse kemi një riparim të veturës – Xhip të Kryetarit. Sa i përket të hyrave vetanake ne i kemi pasqyruar ashtu si janë në realitet. Sa i përket shpenzimet e asamblesë unë ja kam dërguar Kryesuesit një raporte se ku janë bërë ato shpenzime dhe nëse kryesuesi ka interes mundet i shumëzoi dhe të ju shpërndaj. Fatmiri pyeti për udhëtimet për nxënës nga fshati për në shkollë të mesme, shkollat që ju paguhen udhëtimet janë: Në Zatriq, Mrasor, Kramovik dhe Kaznik, po ashtu janë edhe 14 nxënës të tjerë në bazë të kërkesave për nevojat e veçanta të cilën ja paguajnë udhëtimet ndarës nëpër lokalitete të ndryshme, se pse është ritë në krahasim me vitin e kaluar është kjo që kryetari i ka dalë në ndihmë këtyre fëmijëve në nevojë. Tek krahasimi i shpenzimeve në mallra dhe mëditje dhe krahasim i të hyrave që është duke e bërë Fatmiri, ne jemi e vetmja komunë në Kosovë që primë që të hyrat vetanake 94 % shkojnë në investime kapitale dhe nuk shkojnë në mallra. Tek shpenzimet e gjykatës ka një rritje për shkak të marrëveshjeve që i kemi bërë me përmbaruesin privat. Kemi qenë një pyetje se a keni bërë planifikim për falje të borxhit për vitin 2015, vendimi për falje borxhi nuk ka qenë në fillim të vitit kur e kemi aprovuar buxhetin por ka ndodhë më vonë dhe kjo është arsye se pse ne nuk kemi mundur të planifikojmë në buxhetin e 2015. Kam një shpresë se këto muaj që na kanë mbetur do ti realizojmë këto të hyra. Gjohet e gjykatës dhe policisë na vijnë çdo 6 muaj dhe prandaj në këtë 6 mujorin e dytë nuk mundemi të parashikojmë se si është gjendja. Të hyrat nga gjohet në trafik do të ketë edhe ma shumë rrënjë në realizim për arsye se nuk janë duke u konfiskuar dokumentet. Tek ZLK-ja rritje kemi për shkak pagesës së mëditjeve të këshillit të Hoçës së Madhe, arsyeja është se mjetet që i ka ndarë qeveria qendrore për këtë këshill janë derdhur në ZLK sepse nuk kemi pas kod tjetër të posaçëm. Kadria ka pyetur se pse janë ritë shpenzimet e postës, arsyeja është marrëveshja nëpërmjet përmbaruesit për faturat e tatimit në pronë ku ka qenë një borxhe rreth 13.000 € na ka mbetur vetëm edhe një këste për me shlye komplet këtë borxh. Krahasimin që e bëri Azbiu për regjistrim dhe sigurim të automjeteve pse diku shuma ma e vogël diku më e madhe, ne ende kemi borxh për sigurim për vitin 2012, prandaj kemi në disa pozicione vetëm sigurim sepse ka qen borxh kurse regjistrim nuk mundemi me mbet borxh sepse paguhet përmjherë. Total raporti në krahasim me të njëjtën periudhë që pyet Afrimi, tek kodi 13 460 tek vërejtjet shuma prej 13,892.00 € është donacion i cili nuk është pasqyruar në pasqyrat e 2014 dhe prandaj ndryshon totali.

Rukije Krasniqi – Nëse Kuvendi ka një veturë a mundemi ne si Grup jo Formal i Grave ta huazojmë ata veturë kur të kemi nevojë sepse po kemi shumë problem rreth transportit.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, në kodin inspektimi urban i cili ka qenë vitin e kaluar, në atë kod janë mbledhur të gjitha të hyra dhe po ashtu edhe disa të hyrat e drejtorive tjera, por pas rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm që na ka dhënë në raportin e përgjithshëm se duhet të ndahet një kod i veçantë për leje ndërtimi dhe kodin për demolim dhe rrënim, në vitin 2015 ne i kemi ndarë këto kode si kode të veçanta. Gjendja aktuale në drejtorin e urbanizmit deri në shtator të vitit 2015, për leje ndërtimore 9,852.00 € ndërsa për leje për rrënim dhe demolim 2,081.00 €. Në këtë raporte nuk figuron askund lejet mjedisore me siguri ka kaluar në ndonjë kod tjetër, vlera e të hyrave të sektorit për mbrojtje të mjedisit është 3,450.00 €. Mendoj se do të marrim rekomandime nga auditori i përgjithshëm edhe për ndarjen e këtyre kodeve tjera. Të hyrat në drejtorin e urbanizmit për këto 9 muaj janë 20,410.00 €.

Kryesuesi – Kam një vërejtje dhe sugjerim për drejtorin e financave, për mallrat dhe shërbime ka paguar mëditjet prej muajit të 2-të dhe nuk i ka paguar prej mëditjeve ndërsa 9.000 € thotë se i ka mare në rishikim të buxhetit ministria. Në të ardhmen është mirë njëherë të shpenzohen mjetet prej pagave dhe mëditjeve e pastaj të dilet në mallra dhe shërbime. Sa i përket mëditjeve unë së bashku me Florijen kemi pas nga 5 mëditje në Kroaci që kemi qen dhe 3 mëditje në Durrës ku kemi qen unë Selimi dhe Rasimi. Po ashtu shpenzimi tjetër është në ushqim dhe pije 1,395.00 € që është bërë për Egzodin në Xërxë këtë vendim e kemi mare ne si kuvend, po ashtu këtu hynë edhe një drekë që është organizuar për vreshtar, derivatet janë për veturat që unë i kam shpenzuar për punët e ndryshme. Shpenzimet më të mëdha janë bërë mëditjet të cilët janë bërë Komitetit për Komitete, KKSB-së dhe komisioneve të ndryshme të cilët janë formuar nga kuvendi, pra këto janë në bazë raportit.

Afrim Limani - Drejtor ai shpenzim për rregullimin e veturës të cilën e shfrytëzon Kryetari i komunës është dashur të regjistrohet në kuadër të drejtorisë së financave sepse ajo veturë ka qenë në pronësi të drejtorisë për financa.

Kryetari Vehapi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, më erdhe shumë mirë që e pëlqyet raportin sa i përket detaizimit të tij, pati edhe disa vërejtje dhe disa paqartësi, mirë është që keni bërë vërejtje sepse çdo raporte ka edhe të metat e veta. Afrimi e pati një vërejtje me vend kur tha se duhet të plotësohet me atë

komponentin e zyrës së auditorit, mirëpo unë e kam një shqetësim sepse vazhdimisht nëpër dokumente zyrtare shoh gabime teknike, prandaj i lusë si drejtorët ashtu edhe shërbyesit civilë që mos të lëshojnë këto gabime në dokumentet zyrtare sepse ata janë përgjegjës për ato dokumente. Po ashtu kam një sugjerim për drejtorë që të shikohet se çka dhe ku shpenzohen parat publike.

Kryesuesi – E qesë në aprovim pikën e 2 të rendit të ditës: Konstatohet se me 3 abstenime dhe asnjë kundër është aprovuar pika e 2 –të e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Raportit për përfundimin e vitit shkollor 2014/2015 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2015/2016,

Florije Boshnjalu – Gjatë takimeve që kemi mbajtur me grupet jo formal të grave në nivel të komunës së Rahovecit kemi ardhur në një propozim që në komunën tonë të mbahet mësimi jo formal, arsyeja është se pse të shkojnë qytetarët të komunës sonë të kryejnë shkollën në Prizren ose Gjakovë dhe të paguajnë nga 300 € kur munden në Rahovec, kërkesa jonë është a ka mundësi që ju si drejtori të bëni një kërkesë në MASH që këto provime në fund vite të kryhen në Rahovec. Kryetar ne duam edhe një mbështetje nga ana juaj.

Kryetari Vehapi – Në parim unë jam për, por duhet të shikohet se a kemi të drejtë dhe si shkojnë këto procedura për aplikim në ministri dhe po ashtu të shikojmë se a do të ketë implikime buxhetore.

Vjollca Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë, po ja japë edhe unë një përgjigje Florijes sepse jam interesuar për këtë çështje, janë disa procedura të cilat duhet të kryhen përmes kandidatëve dhe shkollave. Kandidatët duhet të bëjnë kërkesë në shkollë, shkollat në drejtorin e arsimit e pastaj ne si drejtori në MASH. Ne si drejtori kemi mbajtur takime të rregullta me Ministrin e Arsimit, po ashtu kemi mbajtur takime të rregullta edhe me drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave si ato të mesme dhe fillore. Është formuar një komision për vizita sistematike në shkollë për evidentimin për së afërmi të nevojave të shkollave dhe mbarëvajtjes së mësimit arsimor dhe për rritjen e cilësisë në arsim. Në bazë të rekomandimeve të inspektoratit të arsimit në Gjakovë dhe inspektoratit të punës në Prizren janë rishpallur dhe shpallur konkurse. Shkollat si ato të mesme dhe fillore kanë marrë pjesë në garat si ato që janë organizuar brenda komunës dhe në nivel Kosove, ku shkollat tona si ato fillore po ashtu edhe ato të mesme kanë pasur rezultate të mira. Është organizuar edhe testi provues për maturantët e shkollave të mesme. Komuna e Rahovecit është përzgjedhur edhe në pilot projektin PISA, ky test ka karakterin ndërkombëtar. Është mbajtur edhe testi i aritshmërisë për klasat e 9-nta, po ashtu me 6 qershor është mbajtur afati i parë i testit të maturës shtetërore ndërsa me 20.06 2015 është mbajtur pjesa e dytë. Ka përfunduar në gjitha shkollat fillore regjistrimi i nxënësve për edukimin para fillor dhe për klasat e para, gjithashtu është bërë regjistrimi i nxënësve në klasat e 10 –ta. Një risi që kemi pasur për këtë vit është se e kemi hapur profilin e stomatologjisë në shkollën profesionale. Janë bërë disa intervenime në dyshimet dhe ndrimet të dyerve në disa shkollë. Fillimi i vitit shkollor 2015/2016 ka filluar me 1 shtator në të gjitha shkollat e komunës, gjatë kësaj periudhe janë bërë disa emërimet dhe riemërimet të shkollave. Komuna e Rahovecit ka këtë përbërje të shkollave: 3 shkollë të mesme, 1 shkollë profesionale, 23 shkollë të mesëm të ulëta, 10 paralele të ndara, 1 çerdhe të fëmijëve, 1 shkollë të ulët të muzikës, 1 shkollë të mesme serbe, 1 shkollë fillore serbe, të bashkangjitur në raportin që ju kemi shpërnda e keni edhe numrin e nxënësve për vitin shkollor 2014/2015. Gjithsej në shkollat serbe punojnë 7 mësimdhënës. Numri i përgjithshëm i punëtorëve të arsimit 2014/2015 janë 875 punëtor bashkë me lehonat dhe punëtor me gjysmë norme. Ne si drejtori e arsimit i kemi ndarë projektet në projekte të kryera, projekte në vazhdim dhe projektet të synuar për vitin 2016 të cilat edhe janë cekur në raport. Sfidë për drejtorin e arsimit për këtë vit ka qenë sistemimi i punëtorëve të arsimit kjo ka ardhur si pasojë e zvogëlimit të numrit të nxënësve.

Kryesuesi – Drejtoresh tek shkollat në zënë malore numri në 2014 numri nxënësve 897 ndërsa në vitin 2015 numri në këto zona është zbritur në 593 nxënës, mos është ndonjë gabim teknik dhe po ashtu nuk po kuptoj se çka ke dashur të thuash me zona malore. Po ashtu propozoj që të zgjidhet problemi i klasave të kombinuara sepse nuk ka kurrfarë efekte të mësimit me klasë të kombinuara. Po ashtu kush janë personat e komisionit të cilët i bëjnë shkollave vizita sistematike, po ashtu dua ta di a janë profesionalisht të përgatitur për të bërë këto vizita nëpër shkollë.

Vjollca Vuçitërna – Kryesisht këto shkollë janë shkollë që frekuentohen në zona malore, sa i përket ramjes së numrit të nxënësve për vitin 2015 janë të dhënat e sigurta ndërsa ato të vitit 2014 unë ashtu i kam gjetur. Sa i përket zgjidhjes së problemit për klasat e kombinuara, ne kemi biseduar edhe me kryetarët e këshillit të fshatrave të atyre shkollave të cilat i kanë klasat e kombinuara dhe kam kërkuar që të bëhet bartja e nxënësve në fshatrat që i kanë më afër, por problemi është se nuk janë duke u pajtuar që të bëhet bartja e nxënësve. Personat të cilat bëjnë vizitat sistematike nëpër shkollë ata janë zyrtarët e drejtorisë së arsimit.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë, në këtë raport është dashur të prezantohet edhe një tabelë të ceket shkolla sa paralele ka pas ajo shkolla, numrin e nxënësve të asaj shkolle dhe të bëhet një krahasim sa ka qenë numri i nxënësve në paralele në vitin paraprak dhe sa është në këtë vite dhe të shikohet se a ka pas rritje të numrit apo zvogëlim të numrit të nxënësve. Shumë shkolla kanë nevojë për riparime, është mirë që të shikohet në atë drejtim me ato mundësi sa i ka kjo drejtori. Kam një kërkesë për drejtoreshën që të shikohet mundësia që përmes ndonjë donacioni të instalohen në të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit nxehjet qendrore.

Fatmir Iska – Kam 2 pyetje për drejtoreshën. Sa e di shkollat fillore janë të obliguara me ligje për nxënës ndërsa në tabelarin faqe 4 jam duke parë që në shkollat fillore kanë përsëritur nxënës klasat, dua ta di a kanë të drejtë ti përsërisin nxënësit klasat në shkollat fillore. Pyetja e dytë është, a ka të punësuar në këtë vite mësimdhënës që janë jashtë komunës sonë edhe pse me ligje e dimë që është e lejuar por nëse kemi kuadro të atyre profileve të cilat kërkohen pse të punësojmë nga komunat e tjera.

Selim Duraku – Mendoj se shqetësimi ma i madhe për komunën tonë është mungesa e numrit të nxënësve të cilët dita ditës vetëm sa shkon e zvogëlohet, propozoj që komuna të mere masë për motivimin dhe shtimin e natalitetit në komunën tonë. Dua një sqarim nga drejtoresha se çka do të thotë nxënës të pa notuar. Tek shkolla Ukshin Hoti në Krushe të Madhe jam duke parë se 48 nxënës janë me nga 3 ose ma shumë nota të dobëta edhe për këtë dua një sqarim nga drejtoresha e DKA-së.

Përparim Krasniqi – Drejtoresha përmendi se ka qenë në vizita nëpër shkolla, objekti i vjetër i shkollës në Oterush është në një gjendje shumë të keqe, kohët e fundit janë vendosë disa shtylla për të mbajtur pllakën, nëse gjatë sezonit dimëror bie borë është rrezik që ajo pllakë të bije dhe kush do e merë pastaj përgjegjësinë, unë e di se përgjegjësia e parë do i bije Kryetarit të komunës dhe juve si drejtoreshë. Po ashtu është interesante se bankat janë duke ardhur për shkollën e re, ne të gjithë e dimë që në shkollën e re janë përfunduar vetëm punimet e vrazhda asgjë më tepër, për mua është shumë absurde.

Florijsa Boshnjaku – Pajtohem me Selimin kur e ceku atë problematik me nxënës të pa notuar, në vitin 2014/2015 janë 419 nxënës të pa notuar. E pyes drejtoreshën e DKA-së se çfarë hapa ka ndërmarrë për këta nxënës. Tek numri i nxënësve thuhet në raport se në shkollën fillore dhe të mesme të ulët i kemi 8.392 nxënës ndërsa në shkollën e mesme të lartë kemi 20,091 nxënës, nxënësit e shkollave malore në cilën kategori hynë në shkollat fillore apo të mesme, mendoj se nuk është mirë të shkruhet nxënës të shkollave malore. Po ashtu dua ta di se sa janë funksional këshillat e shkollave dhe nëse ka mundësi të na bije një informatë drejtoresha se sa shkolla i kanë këshillat e shkollave profesional.

Besnik Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua ta di se në shkollat tona a kemi ushtrues detyre të drejtorit të shkollës, nëse po sa shkolla kanë ushtrues detyre dhe a do të shpallet konkursi për drejtorë shkolle.

Kadri Dellova – kam një përgjigje për Florijen dhe Selimin, ne që jemi duke punuar në arsim e dimë dhe kemi një përvojë numri i nxënësve të pa notuar prej 490 nuk është i madh, dua të ju njoftoj se si në komunën tonë ashtu edhe në tërë komunat e Kosovës braktisja e shkollave nga nxënësit është e madhe për shkak të migrimin ilegal, pastaj janë edhe faktorë tjerë si martesat e hershme, pastaj nxënësit në mesë të vitit ndërprejnë shkollën. Prandaj mësuesit e shkollave në fund të vitit mësimor të japin raport për ato nxënës dhe të i lënë ata nxënës të pa notuar. Drejtoreshë jemi të zhgënjyer shumë dhe pse nuk e kemi fatin edhe ne si shumë shkollat në Kosovë të kemi një sallë sporti edhe para meje këshilltarët nga Krusha kanë bërë kërkesë por ende asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Sa e di kemi pas një premtim nga Ministria e Kulturës që në vitin 2016 të ndërtohet një Sallë e sporteve, por është e çuditshme se ky projekt është zhdukur. S i përket fushës së sportit edhe kjo fushë nuk i plotëson kushtet për një lojë sepse dheu që është aty paraqet rrezik për nxënësit, prandaj ju lusë juve drejtoreshë që së paku ta bëni këtë pastrim të dheut nga ajo fushë.

Rukije Krasniqi – Lidhur me vitin shkollor 2015/2016, tek qëllimet ngritja e cilësisë në procesin edukativ arsimor në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, mendoj se sipas numrit të nxënësve dhe kriterit të një shkolle shkolla Isa Boletini i ka mbi 1.100 nxënës dhe ka një drejtor dhe një zëvendësdrejtor, ndërsa shkolla fillore Bekim Sylka ka një numër shumë më të vogël se shkolla fillore Isa Boletini ka një numër të barabartë të bordit të drejtorëve, prandaj propozoj që bordit të drejtorëve të shkollës Isa Boletini të i shtohet edhe një përfaqësues qoftë pedagog, psikolog ose mjek i shkollës. Lidhur me trajnimet që janë duke u bërë për mësimdhënës të shkollave unë mendoj krahas korikulës e cila është duke u zhvilluar si në vitin e kaluar dhe tani në këtë vit mendoj se duhet të ketë trajnime lidhur me mendimin kritik që janë në kuadër të korikulës mësimore.

Astrit Thaqi – Përshëndetje për të gjithë, desha ta pyes drejtoreshën se a ka ndonjë ndikim tek arsimtarët e shkollave, pikërisht tek shkolla fillore në Kramovik ka grupacione në mes vetë stafit mësimdhënës, sepse për

fajin e tyre janë duke pasuar nxënësit e kësaj shkolle, lusë drejtoreshën që të shkojë dhe të bisedoj me këta arsimtarë.

Afrim Limani – Falënderoj drejtoreshën për raportin por i kisha propozu drejtoreshës që në raportin e ardhshëm kur është fjala tek mungesat e nxënësve të krijohet edhe një tabelar shtesë dhe të futen edhe mungesat e mësimitdhënësve sepse kam një përshtypje se ma shumë mungojnë mësimitdhënësit se nxënësit.

Marigona Berisha – Përsëendetje për gjithë, jemi duke parë se çdo herë e më shumë shkollat nëpër fshatra janë duke pasur më pak nxënës nga faktorët e ndryshëm siç janë rrënja e natalitetit, migrimi dhe po ashtu bartja e banorëve nga fshati në qytet dhe si rezultat i kësaj klasat nëpër qytet janë të mbingarkuara me nxënës. Kam një sugjerim për DKA-në pse nuk i bëjnë një kërkesë Ministrisë së Arsimit që të hapen paralelet e shkollave në qytet që janë në fshatra.

Mirjeta Krasniqi – Përsëendetje për të gjithë, sa i përket normës së mësimitdhënësve ka shumë mësimitdhënës që nuk i kanë normë të plotë dhe i ndalet paga ndërsa ka disa mësimitdhënës që kanë normë ma shumë se 20 orë nuk marrin asnjë cent ma shumë, ku mbesin ato mjete nga orët të cilët i mbajnë ma shumë mësimitdhënësit.

Hysni Gashi – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje me drejtoreshën se a dalin që ti vizitojnë shkollat dhe a ballafaqohen praktikisht me problemet e tyre, konkretisht në fshatin Nagavcë a keni qenë ndonjëherë dhe nëse keni qenë a ju kanë prezantuar problemet e kësaj shkolle. Kjo shkollë tash në sezonin dimërorë ka problem tek hyrja e shkollës dhe mundë të hyjë uji në katin e parë dhe ta dëmtoj komplet katin e parë, me shumë pak investime mundë të evitohet ky problem. Mua më kanë thanë që shumë herë ju kanë drejtuar DKA-së me shkrim por ende nuk kanë gjetë mbështetje.

Vjollca Vuçitërna – Po filloj me Rasimin për sugjerimin që e dha për një pasqyrë shtesë, do ta kem parasysh këtë sugjerim, sa i përket riparimit të shkollave ne jemi të vetishëm se shumica e shkollave tona kërkojnë një riparim dhe një investim po ne jemi duke bërë çmos me atë buxhet sa kemi për riparimin e këtyre shkollave. Fatmiri pyeti se a kanë të drejtë të përsërisin vitin nxënësit e shkollave fillore, Fatmir kanë të drejtë të përsërisin vitin por vetëm me pëlqimin e prindërve. Punëtor të arsimit këtë vite nuk kemi pranuar jashtë komunës sonë. Sa i preket të nxënësve të pa notuar ne kemi një tabelar që na vije nga Ministria e Arsimit ku jepën komplet të dhënat nga shkollat, nxënësit të pa notuar hynë në kategorinë e atyre nxënësve të cilët e braktisin shkollën, nxënësit të cilët bëjnë lëvizje nga shkolla në shkollë. Selimi pyeti se pse në shkollën Ukshin Hoti 47 nxënës me nota të dobëta, është shumë normale për një shkollë të mesme me një numër të madh të nxënësve të ketë këtë numër të nxënësve me nota të dobëta. Përparim e di se është shqetësuese rasti i shkollës në Opterush, kam qen edhe unë disa herë vetë atje për ta parë për së afërmi atë shkollë, ne kemi bërë një zgjidhje të përkohshëm deri sa të rregullohet shkolla e re, ne i kemi dërguar inxhinierët e komunës në shkollën e vjetër për ta bërë një zgjidhje për një kohë të caktuar dhe ata na kanë siguruar se ato shtylla do të qëndrojnë dhe nuk do të ketë rrezik për nxënës. Besoj se shkolla e re në Opterush do jetë e gatshme me 1 shtator të vitit të ardhshëm. Sa i përket bankave dhe karikave ne i kemi bërë kërkesë ministrisë për dy shkollat e komunës sonë, në shkollën e Opterushës sipas informatave që i kam unë nga drejtori i shkollës ai më ka informuar se të premten do të vinë karikat dhe bankat, por prapë unë para se të vije sot në kuvend kam biseduar me drejtorin e shkollës ai nuk më ka informuar për ardhjen e këtyre bankave. por do të interesohem për këtë.

Përparim Krasniqi – Drejtoresh nuk paske informata se karikat dhe bankat kanë ardhë në shkollë dhe çka është ma skandaloze e kanë uzurpuar komplet një klasë për ti futur ato karika dhe banka të reja.

Beatrisa Demiri – Falënderoj drejtoreshën për këtë raport, kam një propozim gjithmonë duke i shikuar mundësit që i keni ju si drejtori. Propozoj që dy shkollat me numër më të madh në qytet që janë dhe shkollat e tjera në komunën tonë që kanë numër më të madh se 500 nxënës të pajisen me kamera, mendoj se shumë probleme do ti kishim evituar, prandaj propozoj se nëse do ketë ndonjë donacion le të jetë kjo si prioritet për ju.

Vjollca Vuçitërna – Florija Pyeti se pse emërohen nxënës në zona malore, këta nxënës janë nxënës të cilat frekuentojnë shkollat që janë në zona malore dhe janë nxënës të shkollave fillore. Ky emërtim është nga ministra e arsimit dhe jo nga ne si drejtori. Sa i përket ushtrues detyre të drejtorëve të shkollës kemi 10 ushtrues detyre, gjatë muajit gushtë e kemi shpallur një konkurs për drejtorë dhe ky konkurs është anuluar për arsye të mungesës së certifikimit për menaxhim. Sa i përket pyetjes që e bëri Astriti se ka grupacione të mësimitdhënësve nëpër shkolla ne nuk kemi ndonjë informatë, por nëse ke ne do shkojmë dhe do e zgjidhim këtë problem. Ndërsa për orët e tepërta që i përmendi dikush është udhëzimi administrativ ku cekë se norma e plotë është 20 orë ndërsa rregull e pashkruar është deri në 24 orë varësisht nga lëndët sepse ka lëndë që duhet të ndiqet 5 orë brenda javës. Sa i përket kamerave ne e kemi që nga fillimi këtë si prioritet në gjitha shkollat, ne jemi në kërkim të donacioneve dhe në atë moment që na vije ndonjë donacion ajo do të jetë si prioritet. Personalisht nuk e kam vizituar shkollën brenda në

fshatin Nagavc, javën e kaluar përgjegjësi i shkollës së Nagavcit ka ardhur dhe më ka njoftuar me gjendjen e shkollës dhe unë prej tij kam kërkuar që ta bëjë një parallogari dhe të shohim se çka mundemi të bëjmë për evitimin e këtij problemi. Kadria pyeti se a kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit për një sallë sportive për Krushen e Madhe, personalisht dy herë kam bërë kërkesë për Krushe dhe Ratkocë dhe dy shkolla në Rahovec, por për momentin nuk kemi asnjë përgjigje nga ministria. Afrimi propozoj që të shtohet edhe një kolonë për mungesë të mësimdhënësve, Afrim si nxënësit ashtu edhe mësimdhënësit janë duke u ndëshkuar sepse për çdo mungesë do i hiqet mëdijtja.

Hysni Gashi – Është mirë që të dilni ma shpesh që ti vizitoni shkollat sepse ne nuk mundemi të gjitha problemet që i kanë shkollat të ju shprehim. Po ashtu kam një vërejtje për Kryesuesin sepse kur fletë dikush në kuvend të tjerët duhet të dëgjojnë ndërsa këtu situata del ashtë kontrollit.

Kryesuesi – Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Marrja e Vendimit për vënie në debat publik të Rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Rahovecit,

Edhe kjo rregullore është debatuar në KPF dhe kanë dalë disa rekomandime që zyra ligjore ti bëjë disa përmisime në vërejtjet që i kanë dhënë kuvendarët.

Osman Hasku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, dua ti cek disa vërejtje në nene që i kemi pasur në KPF, duke filluar nga neni 12, 13, 15, të cilët sipas anëtarëve të KPF bëjnë dualizëm apo janë vetëm përshkrim i udhëzimit administrative 10/2010. Ne si drejtori kemi kërkuar sqarim nga zyra ligjore dhe sqarimi nga zyra ligjore qëndron si në vijim: Këtë draft rregullore e ka përpiluar OSBE-ja me ekspertët e tyre dhe duke kaluar nëpër zyre ligjore kemi konstatuar që kjo draft rregullore nuk duhet të pësoj ndryshime për momentin për arsye se kjo rregullore do ti nënshtrohet debateve publike.

Florië Boshnjaku – Tek neni 20 thuhet: Aktivitetet vullnetare duhet të jenë pjesë e planifikimeve buxhetore komunale, pyetja ime është a keni parapa ju si qeveri buxhet për vitin 2016 për këtë rregullore.

Përparim Krasniqi – PO ashtu edhe unë e kam një pyetje tek neni 20, çfarë forme do të jetë ky planifikim buxhetor nëse do të kemi shumë vullnetarizëm dhe a do të ketë mundësi komuna të mbuloj.

Rukije Krasniqi – Falënderoj drejtori për këtë rregullore, kjo rregullore i motivon të rinjtë për një punë vullnetare dhe fitojnë shprehje të punës ku sipas nenit 4 janë disa prioritete të cilët këta vullnetar do i gëzojnë, mendoj se kjo rregullore është në të mirën e gjithë shoqërie.

Osman Hasku – Ju falënderoj për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja, në nenin 16 e keni motivimin e punës vullnetare ku janë 13 pika, sa e di unë punët vullnetare nuk paguhën ndërsa të gjitha aspektet teknike i përkasin Drejtorisë së Kulturës. Planifikimet buxhetore janë kërkuar nga udhëzimi administrativ për rregullore komunale që të përfshinë në nenin 20 aktivitetet vullnetare dhe të jenë pjesë e planifikimit buxhetorë.

Beatrisa Demiri – Drejtor dua një sqarim rreth një shahiste e cila ka pas me merë pjesë në kampionatin botëror, sipas informatave që i kam ajo ka kërkuar një shumë prej 300 € dhe ju si drejtori nuk keni pas mundësi që të ja siguron. Pra dua një sqarim rreth kësaj se mendoj se komuna nuk do të lejoj që për 300 € të mos shkoj në kampionatin botërorë, mendoj se është keqkuptuar diçka këtu.

Osman Hasku – Ju siç e dini subvencionet nga drejtoria për rini dhe sporte i kemi ndarë së bashku në kuvend, siç e dini me 28.02.2015 janë përcaktuar të gjitha subvencionet dhe ky klub i shahut i ka marrë 1.700 € subvencione nga drejtoria e kulturës, pse udhëheqësi i shoqatës së shahut nuk i ka planifikuar këto udhëtime për këtë vajzë unë nuk i kam fajet dhe për shkak të mungesës buxhetore është refuzuar kërkesa për këtë vajzë.

Kryesuesi – E qesë në aprovim pikën e 4 të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Projekt Rregullores për plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba 01 Nr.238 të datës 30.01.2015,

Këtu kemi të bëjmë me një taks komunale e cila deri më tani ka qenë në kompetencë të ministrisë të agjencionit të veterinarisë dhe ushqimit ndërsa tani ka kaluar në kompetencë të komunës, kështu që ne [është dashur që ta qesim në rregullore me urgjencë, mbase ka qen me urgjencë ne sot e kemi futur si pikë të rendit të ditës për këtë mbledhje. Përndryshe rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba do të shqyrtohet dhe aprovohet me siguri ka muaji shkurt i vitit të ardhshëm.

Muhamet Behra – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kjo pikë ka të bëjë me plotësim ndryshimin e rregullores sa i përket drejtorisë për punë inspektuese ku ka të bëjë me taksën e kontrollit të therjes së kafshëve në thertoret e licencuara që gjinden në komunën e Rahovecit. Deri më tani këtë taksë e kanë pas agjensioni i veterinarisë dhe ushqimit, kështu që bazuar në njoftimin e këtij agjensioni me datë 01.06.2015 jemi njoftuar që

tash tutje kjo taksë do të kaloj në kompetencë të kuvendeve komunale, konkretisht në drejtorin inspektuese. Në rregulloren komunale për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa konkretisht në nenin 20 i cili ka të bëjë me punën inspektuese nuk është e përfshirë kjo taksë, kërkoj që vendim plotësimi për ndryshimin kësaj rregullore të shqyrtohet dhe të futet si taksë e re në kuadër të kësaj rregullore.

Selim Duraku – Sa thertore janë të licencuar në komunën tonë.

Muhamet Behra – Në komunën e tonë janë 5 thertore të licencuara nga agjencioni i ushqimit dhe veterinës.

Kryesuesi – E qesë në aprovim kërkesën për plotësim ndryshim të rregullores: konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar ndryshimi dhe plotësimi në rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba. Kalojmë pikën e radhës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi Draft Planit Lokal të Veprimit për ri integrim,

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë, Ky është një draft planë për ri integrim i cili është kërkuar nga komuna jonë që të përpilohet në mënyrë që në mbledhjen e nëntorit ta qesim në rend të ditës për aprovim e pastaj të dërgohet në ministrin përkatëse. Këtë draft planë e ka formuar një komision të cilin e ka formuar Kryetari i komunës. Ky planë nuk ka implikime buxhetore në nivel komune, por dot ë bëhet financimi nga departamenti i riadhesimit të qytetarëve që është në kompetencë të Ministrisë së Brendshme. Sipas disa parametrave që i kemi pas edhe ma herët janë parallogaritur shpenzimet në disa pika këtu të cilat do të referohen. Është bërë një total i përgjithshëm i cili do të dërgohet Ministrisë së Brendshme për aprovim të këtij plani. Nuk është ky vit i parë që është bërë ky planë për ri integrim, është bërë edhe viteve tjera por tash do ti ketë disa kompetenca shtesë komuna të cilat deri më tani i ka pas një departament nga Ministria e Brendshme.

Selim Duraku – Desha ti mare disa shembuj nga personat që janë riadhesuar ma herët. Njoh personalisht 2 ose 3 familje që i kanë kushtet e rënda që i kanë kthyer nga shteti Gjerman, ata kanë bërë disa kërkesa për ndihmë por askush nuk i ka ofruar ndihmë. Pyetja ime është deri në sa vite vlen kjo ndihmë e riadhesimit.

Nënkryetari – Ndihmë i afrohet të gjithë atyre që janë të riadhesuar për 2 vite mbas dy vite nuk ka.

Kryesuesi – Kjo është më shumë një kriter që duhet ta përmbushin të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, po ashtu ky është një parakusht për liberalizim të vizave.

Florije Boshnjaku – Dua ta di se kush është sponsorizua i këtij Draft Planit. Po ashtu vlera buxhetore e këtij draft plani është 437,300.00 €, dua ta di a janë këto mjete të ndara apo priten të ndahen në të ardhmen për komunën tonë. Në faqe 5 pika 3.2 thotë ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe medikamente vlere 4.000 €, pastaj ofrimi i shërbimeve psiko sociale, caktimi i specialistit për shërbime psiko sociale nga qendra për mirëqenie sociale, dua ta di se kush janë këta specialistë nga qendra për mirëqenie sociale që do ti ofrojnë shërbime. Faqe 6 asistencë sociale familjeve në nevojë 10.000 €, këtë asistencë sociale e ndanë MPMS sepse komuna nuk ka mundësi të ofroj asistencë sociale. Faqe 6 pika 3.4 ofrimi i mësimi plotësues për nxënës në nevojë 11.500 €, pastaj programet jo formale të arsimit 5.600 €, këtë nuk e kam të qartë. Nostrifikimi i dëftesave dhe diplomave, këtë komuna nuk e bënë por MASH.

Nënkryetari - E nderuara Florije vetëm shikoni legjendën në funde aty e keni çdo gjë të sqaruar. Unë e thash kjo nuk është as formular e as i përpiluar nga komuna, por kryetari i komunës me kërkesën e MB të formojë një komision për futjen e buxhetit i cili do të nevojitet për këto pika që janë cekur. Pra të gjitha këto pika na kanë ardhur nga MB ne vetëm i kemi futur në këtë formular shpenzimet. Tek asistencë sociale nuk është sponsorizues Kryetari i komunës por ministria, por shkon nëpërmjet kryetarit të komunës së person përgjegjës. Sa i përket asaj se a janë të siguruara këto mjete unë nuk e di, por me siguri se do të bëhet ndarja e mjeteve. Medikamentet do të jenë enkas për ata persona që riadhesohen dhe do të paguhet enkas nga ministria.

Kryesuesi – E qesë në aprovim Draft Planin Lokal për ri integrim: Me 2 abstencime dhe të tjerët pro është aprovuar Draft plani lokal për ri integrim. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Përparim Krasniqi – Dua një përgjigje me shkrim nga Drejtori i Bujqësisë? A ka ndonjë kontroll në malet e komunës sonë sepse është duke u bërë tmerr posaçërisht në pjesën nga vij unë, çdo ditë jam duke parë njerëzit që prenë dru pa kurrfarë leje.

Hysni Gashi – Kryesues kush është përgjegjës për web faqen e komunës sepse disa herë kam dashur të shërbehem me procesverbalet e kuvendi por nuk kam mundur të gjej, procesverbali i fundit që ishte aty ishte nga muaji 04.2015. Web faqja e komunës sonë është tepër e mangët në të gjitha aspektet.

Fatmir Iska – Edhe në seancën e kaluar e kam pyetur drejtorin e shërbimeve publike lidhur me rrugën Xhelal Hajda – Toni e cila është shumë e dëmtuar, janë hapur disa gropa. Sa e di unë është një kontratë për sanimin e rrugëve, e pyes drejtorin pse nuk respektohet kjo kontratë dhe pse nuk sanohen këto gropa nëpër rrugët e qytetit.

fshatin Dobidol, këtë pyetje e kam bërë edhe më parë dhe drejtori më ka dhënë një përgjigje se këtë vite në këtë fshat do të kryhet një pjesë e rrugës, ne jemi në përfundim të muajit nëntor dhe asgjë nuk është bërë.

Rukije Krasniqi – Kam një pyetje lidhur me pagesën e udhëtimit të mësimdhënësve, mua më duket se është marrë një vendim, dua ta di se pse nuk është duke u zbatuar së paku një drejtim të paguhen nëse nuk ka buxhet për dy drejtime. Pyetja tjetër është sipas kontratës që e kemi nënshkruar mësimdhënësi i ka 20 orë pune, pse nuk janë duke u paguar mësimdhënësit për orët shtesë që janë duke i mbajtur.

Selim Duraku – pyetja ime është për Drejtorin e Shërbimeve Publike, çdo herë që kam bërë pyetje për ndriçimin publikë ai më është përgjigjur se janë duke bërë pagesat të rregullta Kedsit. Ndërsa unë vetë personalisht jam interesuar dhe kam parë që asnjë pagesë nuk është bërë për ndriçimin publik të Krushës. Kërkoj nga drejtori i shërbimeve publike që në mbledhjen e ardhshme të bëjë një sqarim rreth këtij problemi.

Lulzim Sylejmnai – Të njëjtën pyetje e kemi pasur edhe në lagjen e serbeve, për një problem të një ndërprerësi ata ishin të bindur se ju është shkyçur rryma. Prandaj Selim nuk është e vërtetë se e ka shkyçur KEKU por ka defekte teknike. Po ashtu asnjë faturë e ndriçimit publik të Krushës së Madhe e cila është në regionin e Prizrenit nuk ka ardhur e protokolluar në drejtorin e financave për pagesë.

Kadri Dellova – Trotuaret Rrugës Rahovec – Krushe e Madhe e cila shkon përmes fshatit Brestoc janë të mbuluara nga pemët dhe nga balta, nuk janë fare duke u mirëmbajtur, po ashtu kohët e fundit si në qytet ashtu edhe në fshatra trotuaret janë të bllokuara nga veturat dhe gjësendet e lokaleve, me këtë janë të rrezikuar si qytetarët ashtu edhe nxënësit, prandaj ka ardhur koha që këto anomali ne si komunë ti eliminojmë.


Beatrisa Demiri – Po i drejtohem Nënkretarit ndoshta mundet të më përgjigjet: Kam pyetur edhe më parë se si është dhënë kontrata për mirëmbajtësit e varrezave nga qeverisja e kaluar sepse asnjë herë ata nuk i kanë raportuar qeverisë së kaluar për mirëmbajtje të varrezave. A ka mundësi që në mbledhjen e kaluar të na jepni ndonjë informatë në çfarë mënyre ata i kanë bërë pastrimin e varrezave.

Nënkrjetari – E nderuara znj. Beatrisa mos i ke ngatërruar përgjigjet sepse këtu kemi të bëjmë me mirëmbajtjen e varrezat e dëshmorëve dhe lapidarëve sepse asnjëherë përveç vitin e kaluar nuk ka pas kontratë për pastrimin e varrezave publike. Po ashtu mendoj se me 14.000 € nuk mundet të bëhet pastrimi i komplet varrezave publike në tërë komunën e Rahovecit.

Kryesuesi - Mendoj se 14.000 € nuk janë pak për pastrimin e varrezave publike, ne vetëm një praktik tjetër të bëjmë që në secilin fshatë dhe qytet ti punësojmë nga dy persona do i mirëmbajnë varrezat shumë ma mirë se kjo kompani. Ju faleminderit për pjesëmarrje me kaq përfundon kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 13.00

Procesmbajtësi,
Skender Hamza



Kryesuesi
Nahit Elshani

